




**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO**

**KOMUNA E GJILANIT**  
**OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI**



---

Adresa:rr.”Adem Jashari” pn, [ëëë.rks-gov.net/gjilan](http://ee.rks-gov.net/gjilan), tel.0280 320 781, 0280 320 782, 0280 321 482, 0280 321 486

---

Duke u bazuar në nenin 40.2 shkronja l) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, në nenin 39 paragrafi 1.4, të Statutit të Komunës së Gjilanit, si dhe bazuar në Rekomandimin e Komitetit për Politikë dhe Financa të datës 30.01.2012, Kuvendi i Komunës së Gjilanit, në seancën e mbajtur me 09.02.2012, miraton këtë:

**V E N D I M**

**PËR MIRATIMIN E RAPORTIT TË PUNËS TË KOMISIONIT PËR**  
**VLERËSIMIN E ASETEVE TË KRM “HIGJIENA”**

**I**

Me këtë vendim Kuvendi i Komunës së Gjilanit miraton Raportin e punës të Komisionit për vlerësimin e aseteve fikse dhe obligimeve të KRM “Higjiena”.

**II**

Pjesë përbërëse e këtij vendimi është Raporti i punës të Komisionit për vlerësimin e aseteve fikse dhe obligimeve të KRM “Higjiena”.

**III**

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës së Gjilanit.

01.Nr. 16/16502  
Gjilan, më 09.02.2012

Kuvendi i Komunës,  
\_\_\_\_\_  
Izmi ZEKA, Kryesues